



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.77/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi, dhe Violeta Rugova Husaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik “Kosova Demokratik Türk Partisi”-Fikrim Damka, me seli në Prizren, e parashtruar kundër subjektit politik “Yenilikçi Türk Hareket Partisi”, me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhet si e pasafatshme, ankesa e Subjektit politik “Kosova Demokratik Türk Partisi”, me seli në Prizren, ZL.A.nr.77/2025, e datës 29.09.2025, e paraqitur kundër subjektit politik “Yenilikçi Türk Hareket Partisi”, me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 29.09.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga “Kosova Demokratik Türk Partisi” - Fikrim Damka, të paraqitur kundër subjektit politik “Yenilikçi Türk Hareket Partisi”, në të cilën pretendohet se YTHP për shkak të publikimit të bërë në faqet e tyre zyrtare, ku ishte prezantuar një marrëveshje e pretenduar ndërmjet Fehmi Kupinës, themelues i lëvizjes “Lidhja e Prishtinës”, dhe nënkryetarit të YTHP-së Kemal Dobircan, duke e paraqitur këtë si kandidat i listës së përbashkët për Prishtinën. Ky veprim bie ndesh me ligjin dhe me afatet e përcaktuara nga KQZ për njoftimin dhe certifikimin e koalicioneve, si dhe krijon rrezik të qartë për mashtrim dhe dezinformim të votuesve, veçanërisht të komunitetit turk të Prishtinës, duke cenuar parimet e qartësisë dhe transparencës që duhet të mbizotërojnë gjatë procesit zgjedhor. Me tutje thekson se konform dispozitave të Ligjit nr.08/L-228, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenet që rregullojnë njoftimin dhe certifikimin e subjekteve politike, afatet për dorëzimin e listave dhe ndalimin e prezantimeve që mund të shkaktojnë ngatërrim ose mashtrim, bëjnë të qartë se çdo marrëveshje e tillë duhet të bëhet transparente dhe të certifikohet zyrtarisht nga KQZ, ndërsa publikimi i marrëveshjeve të supozuara jashtë këtyre procedurave konsiderohet i jashtëligjshëm dhe mashtrues.

Në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2025, subjekti politik Yenilikçi Türk Hareket Partisi, thekson se bazuar në Rregulloren 01/2025, për procedurën e paraqitjes së ankesave në PZAP, ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara gjatë fushatës zgjedhore, duke përfshirë çështjet për fushatën, mediat dhe sjelljen e subjekteve politike, duhet të paraqiten brenda 48 orëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja. Postimi në fjalë për të cilën bëhet fjalë në ankesë ka ndodhur me datën 25.08.2025, ndërsa ankesa është paraqitur me datë 29.09.2025, pra 27 ditë pas publikimit të kontestuar. Ankuesi z. Fikrim Damka-Kryetar i “Kosova Demokratik Türk Partisi”-KDTP, në ankesën e parashtruar me datë 29.09.2025, ka pretenduar se postimi në rrjetin social Facebook, të kandidatit të Partisë YTHP Edin Kude, të ketë vepruar në kundërshtim me par.1 pika 11 të Nenit 34, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parasheh se “përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfardo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.” dhe kjo nuk qëndron aspak me rastin në fjalë, ngase publikimi përmes rrjetit social Facebook, nuk ka të bëjë me asnjë material i cili nxit ose mund të nxisë apo provokoj një person të tretë për akt dhune, urrejtje apo akti tjetër të ngjashëm. Me tej në përgjigje theksohet se pretendimi i parashtruesit të ankesës citojmë me datë 27.09.2025, në një imazh të publikuar në llogarinë e tij në rrjetet sociale, anëtar i “Yenilikçi Türk Hareket Partisi”, dhe kandidati i të njëjtës parti për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit, Edin Kude, ka përfshirë një listë *postimi në fjalë, nuk përmban një listë, por përmban një dokument zyrtar publik i publikuar nga Komuna e Prizrenit sipas konkursit me nr. RN00018235. Materiali i përdorur në publikim nuk ka të bëjë me nxitje të urrejtjes apo akteve të dhunës, të jetë denigrues apo mashtrues që ndikon në një mënyrë apo tjetër në peceptimin publik ndaj cilitdo person që është i përfshirë në dokumentin publik të publikuar nga komuna e Prizrenit. Publikimi në rrjetin social nuk i është drejtuar asnjë personi dhe nuk ka qenë e qëllimit që të dëmtoj integritetin e garës demokratike dhe përbën ndërhyrje të padrejtë në fushatën zgjedhore të asnjë kandidati.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, provave të bashkangjitura në ankesë dhe përgjigjes në ankesë, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik “Kosova Demokratik Türk Partisi”-Fikrim Damka, me seli në Prizren kundër subjektit politik “Yenilikçi Türk Hareket Partisi” me seli në Prizren, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, ku përcaktohet se “*Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj*”. Ndërsa neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, përcakto se “*PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor*”. Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi, përkatësisht, deklarimi në

ankesë, data e publikimit të fotos në rrjetin social Facebook ndaj të cilës është ushtruar ankesa është e datës 25.08.2025, prandaj Paneli, konform nenit 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin përcakton se *“Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.”* Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pasafatshme, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook, shihet se kandidati Edin Kude nga subjekti politik *“Yenilikçi Türk Hareket Partisi”* ka bërë publikimin në rrjetin social Facebook me datë 25 Gusht 2025, ndërsa ankesa është parashtruar në PZAP më datë 29.09.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orëve.

Në këtë kuptim Paneli duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.77/2025, datë 01.10.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.